



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 23.16.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË NDËRMARRJES PUBLIKE
HORTIKULTURA SH.A. PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31
DHJETOR 2017

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ndërmarrjes Publike Hortikultura Sh.a., në konsultim me Ndhmës Auditorja e Përgjithshme *Vlora Spanca*, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *udhëheqësi ekipit Ganimete Dalloshi dhe anëtarja ekipit Valmira Jonuzi*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Enver Boqolli*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	12
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	25
5 Qeverisja.....	26
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	30
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	33
Shtojca III: Letër Konfirmimi.....	34

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ndërmarrjes Publike Hortikultura Sh.a. (Hortikultura), për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 17/11/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar bazuar në cilësinë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Hortikulturës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Hortikulturës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.


Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i kundërt

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017, nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale.

Për më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Kryeshefi Ekzekutiv është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Hortikulturës. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Hortikulturës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP-së).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e Menaxhmentit ndaj gjetjeve tona mund të gjenden në Shtojcën III.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i PFV-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. PFV-të përgatiten dhe nënshkruhen nga Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit (ZKFTH) dhe Kryeshefi Ekzekutiv (KE) dhe dorëzohen për miratim në Bordin e Drejtorëve (BD).

PFV-të e miratuara nga BD përfshijnë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë aksionarit dhe publikut të gjerë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i kundërt

Kemi audituar PFV-të e Hortikulturës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe shënimet shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kundërt, pasqyrat vjetore financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë të parimit akrual të kontabilitetit, Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

Baza për opinion të kundërt

Ne kemi krijuar bazën për opinionin të kundërt, për arsyet e përmendura në vijim:

1. Shuma e fitimeve të mbajtura e prezantuar në PFV-të e vitit 2017, krahasuar me shumën e prezantuar në PFV-të e vitit 2016 ishte mbivlerësuar për 5,408€. Ndërsa, në shënimet kontabël saldo e kësaj llogarie ishte 172,299€ respektivisht 28,418€ më pak se sa vlera e prezantuar në PFV. Një mbivlerësim i tillë ishte bërë me qëllim të barazimit të pasqyrës së pozitës financiare.

2. Korniza Konceptuale për Raportimin Financiar paragrafi 4.4 a), përcakton se: një aktiv është një burim i kontrolluar nga njësia ekonomike si rezultat i ngjarjeve në të shkuarën nga të cilat parashikohen përfitime ekonomike të ardhshme që do futen në njësinë ekonomike. Respektivisht paragrafi 4.6 përcakton se gjatë vlerësimit, nëse një zë e plotëson përkufizimin e një aktivi, duhet ti kushtohet vëmendje përmbajtjes themelore të tij dhe realitetit ekonomik dhe jo vetëm formës së tij ligjore.
Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në Hortikulturë, Komuna e Prishtinës gjatë viteve 2013-2017 kishte realizuar blerjen e pajisjeve të ndryshme në vlerë 512,772€. Megjithëse këto pasuri i janë dorëzuar Hortikulturës, dhe si rezultat i shfrytëzimit të tyre rrjedhin përfitime ekonomike në drejtim të saj, ndërmarrja nuk i kishte të regjistruara në regjistrat e saj. Këto pasuri mbahen në regjistrat e pasurive të Komunës së Prishtinës. Kjo kishte ndodhur për shkak se këtij procesi nuk i kishte paraprirë një dokumentim (marrëveshje), ku do të specifikoheshin obligimet dhe të drejtat e të dyja palëve, por vetëm një proces i pranim dorëzimit të këtyre pasurive jo qarkulluese.
3. Hapësira për zyre e cila është në pronësi të Komunës së Prishtinës i është dhënë në shfrytëzim Hortikulturës, në bazë të një marrëveshje për përdorim të përkohshëm, por kostoja e kësaj pasurie nuk ishte njohur, matur dhe regjistruar si pasuri e ndërmarrjes në përputhje me SNK 20.
4. Pasqyra e rrjedhës së parasë nuk prezanton saktë shumën e hyrjeve dhe të daljeve të parasë. Hyrjet e parasë në krahasim me shënimet kontabël ishin mbivlerësuar në vlerë prej 59,425€. Sa i përket daljeve të parasë, pagesat për furnitorë ishin mbivlerësuar për 8,391€, pagesat për tatime ishin nënvlerësuar për 1,850€, dhe zëri i pagesave tjera ishte mbivlerësuar për 57,326€. Ndërsa, 4,443€ nuk ishin prezantuar fare si dalje e parasë.
5. Shënimet shpjeguese nuk japin informacione shpjeguese të plota dhe të sakta, për disa nga zërat e prezantuara në PFV, për më shumë detaje shih nënkaptullin 3.6
6. Në pasqyrën e pozitës financiare zëri “kapitali dhe rezervat” ishte prezantuar në vlerë prej 117,253€, ndërsa në shënimet kontabël ndërmarrja përveç emërtimit dhe vlerës së këtij zëri nuk posedon informacion lidhur me përbërjen e kësaj shume. Kjo si pasojë e ndërrimit të programit të kontabilitetit, ku nuk ishin inkorporuar evidencat analitike por vetëm saldot.

Gabimi i përgjithshëm për çështjet e prezantuara nga pika një deri tek pika pesë dhe kufizimi i fushëveprimit të auditimit i prezantuar në pikën gjashtë arrin shumën 789,878€ plus një shumë të pa përcaktuar për shkak të mos vlerësimit dhe regjistrimit të vlerës së hapësirës së zyrës që shfrytëzohet nga ndërmarrja, është materiale dhe e përhapur pasi ajo ndikon në shumë elemente të PFV-ve.

Auditimi jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e PFV-ve’. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore dhe Ndërmarrjeve Publike në Kosovë. ZKA është e pavarur nga Hortikultura dhe përgjegjësitë tjera etike janë

përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kundërt.

Çështje Të tjera

- Gjatë vitit 2017, Hortikultura ishte pa Bord të Drejtorëve dhe rrjedhimisht pa Komision të Auditimit, respektivisht nga nëntori 2014. Gjithashtu, Kryeshefit Ekzekutiv, Zyrtarit Kryesor Financiar dhe i Thesarit, Sekretarit Korporativ dhe Auditorit të Brendshëm iu kishte skaduar kontrata gjatë vitit 2015 dhe të cilët vazhdojnë të punojnë ende.
- Pasqyrat financiare vjetore të Hortikulturës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016 janë audituar nga një kompani private e auditimit, e cila kishte dhënë opinion të kualifikuar, për shkak të saldove përfundimtare të vitit 2015, konkretisht: 1) nënvlerësimi i pronës impianteve dhe pajisjeve për 21,526€ dhe 2) paraja dhe ekuivalentët e sajë janë nënvlerësuar për 2,740€.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryesuesi i Bordit i Hortikulturës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në bazë të parimit aktual sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës, si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Hortikulturës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë

për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

NP kërkohet të veprojë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Në kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiare dhe Auditim;
- Kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik (me ndryshime dhe plotësime);
- Kërkesat e Udhëzimit nr. 2/2013/MF për Strukturën dhe Përbajtjen e Raporteve Financiare Vjetore; dhe

Nga NP, po ashtu kërkohet të përgatisë raportet si në vijim:

- Statuti i NP-së;
- Plani i Biznesit;
- Raporte tremujore;
- Raporte vjetore;
- Raportin nga matja e kënaqshmërisë së Konsumatorëve; dhe
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë.

Në draft PFV-të të datës 09/03/2018 ishin të nevojshme disa korrigjime financiare në pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe shënimet shpjeguese që ishin përcjellë me gabime materiale. Pas sugjerimeve tona për ti bërë veprimet e nevojshme, Hortikultura kishte bërë disa korrigjime, mirëpo nuk kishte arritur t'i eliminojë gabimet në tërësi. Si pasojë e kësaj ne kemi identifikuar të gjeturat të cilat i kemi prezantuar tek baza për opinion.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, PFV-të e përgatitura nga KE dhe ZKFTH me rastin e dorëzimit në BD, nuk mund të konsiderohen të sakta.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, kemi identifikuar mos-pajtueshmëritë si në vijim:

- Raportet tremujore për vitin 2017 të Hortikulturës përmbajnë vetëm një shqyrtim të performancës financiare të tremujorit përkatës, kështu duke përmbushur vetëm një nga pesë kërkesat ligjore lidhur me përmbajtjen e raporteve tremujore siç e kërkon neni 31 i Ligjit të Ndërmarrjeve Publike. Po ashtu, për shkak të mungesës së BD këto raporte ishin të pa miratuara.
- Ekzistojnë dallime midis të dhënave financiare të prezantuara në raportin vjetor 2017 në krahasim me të dhënat e prezantuara në PFV.
- Nuk kishte hartuar raportin nga matja e kënaqshmërisë së konsumatorëve, siç e kërkon neni 29 i Ligjit të Ndërmarrjeve Publike.
- Hortikultura kishte hartuar planin e biznesit sipas kërkesave ligjore mirëpo, ky plan në mungesë të BD dhe KKA ishte i pa miratuar.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi 1 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar tek dhënia e Opinionit të Kundërt. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për të hequr gabimet në pasqyrat financiare vjetore dhe për ta siguruar një pamje të drejte dhe të vërtetë të tyre.

Gjithashtu, Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen BD.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në Hortikultura. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i të hyrave, shpenzimeve, pasurive, detyrimeve dhe llogarive të arkëtueshme.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të Hortikulturës kanë nevojë për përmirësime. Proceset ekzistuese të planifikimit të buxhetit nuk janë adekuate dhe nuk janë mbështetur me rishikim të buxhetit gjatë vitit. Mungesa e kontratave për zyrtarët e lartë të Ndërmarrjes, mungesa e BD dhe KA rrezikojnë funksionimin dhe arritjen e synimeve të Ndërmarrjes.

Më tutje edhe menaxhimi i shpenzimeve ka nevojë për përmirësim. Kjo pasi që mungon zyrtari certifikues, mos pagesa e detyrimeve me kohë ndërmarrjes i ka shkaktuar shpenzime shtesë dhe blerja e furnizimeve pa procedurë të prokurimit, ndikojnë në menaxhim jo të mirë të shpenzimeve.

Po ashtu, kontrollet ekzistuese në menaxhimin e pasurive jo qarkulluese, llogarive të arkëtueshme, detyrimeve dhe kapitalin nuk janë adekuate. Ato kanë pamundësuar regjistrimin dhe raportimin e saktë dhe të plotë të këtyre llogarive si në regjistrat kontabël ashtu edhe në PFV.

Këto dhe dobësitë e tjera të prezantuara në këtë raport duhet të merren në konsideratë nga BD për të përmirësuar menaxhimin financiar dhe kontrollin tek Hortikultura.

3.1 Plani i biznesit (të hyrat dhe shpenzimet)

Ne i kemi shqyrtuar burimet e të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara me planin vjetor të biznesit sipas kategorive përkatëse. Kjo është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 1. Tabela e të hyrave dhe shpenzimeve sipas planit vjetor për vitin 2017 (në €)

Përshkrimi	Planifikimi 2017	Realizimi 2017	Realizimi 2016
Të hyrat nga mirëmbajtja dhe ngritja e sipërfaqeve gjelbëruese në Komunën e Prishtinës	2,432,762	964,615	897,788
Të hyrat nga mirëmbajtja e varrezave në Komunën e Prishtinës	68,000	61,078	60,527
Gjithsej të hyrat	2,500,762	1,025,693	958,315
Shpenzimet e të ardhurave personale (paga dhe mëditje)	1,204,814	855,339	845,155
Shpenzime operative	1,029,485	76,358	92,965
Shpenzimet tjera ¹	40,449	14,600	15,131
Gjithsej Shpenzimet	2,274,748	946,297²	953,251

Shpjegimet rreth ndryshimeve në planifikimin e të hyrave dhe shpenzimeve janë dhënë si në vijim:

- Planifikimi i të hyrave nga shitjet/shërbimet ishte dukshëm më i lartë sesa realizimi i vitit 2016. Të hyrat e realizuara në total janë 1,025,693€, që në raport me planifikimin janë realizuar më pak për 1,475,069 ose 59%. Mosrealizimi i planifikimit të të hyrave vërehet sidomos tek të hyrat nga mirëmbajtja dhe ngritja e sipërfaqeve gjelbëruese në Komunën e Prishtinës, ku realizimi i planit ishte vetëm 40%. Ndërsa, të hyrat nga mirëmbajtja e varrezave në Komunën e Prishtinës janë realizuar 90% e shumës së planifikuar.
- Shpenzimi i buxhetit në raport me planifikimin ishte 42%. Shpenzimet me të larta kishin ndodhur te kategoria paga dhe mëditje, që në totalin e shpenzimeve marrin pjesë me 89%. Vlera e ulët e shpenzuar në raport me buxhetin e planifikuar ishte për shkak të një planifikimi jo real në raport me nevojat e ndërmarrjes.

¹ Shpenzimet tjera paraqesin: shpenzimet kontraktuese, shpenzimet për blerjen e kompjuterëve dhe printerëve, shpenzimet e provizionit të bankës, shpenzimet për reprezentacion dhe shpenzimet për shtypin ditor.

² Për dallim nga Pasqyra e të Ardhurave, këtu nuk përfshihen shpenzimet e zhvlerësimit.

Çështja 2 – Realizim i ulët i planit të biznesit

- E gjetura** Në planin e biznesit, Hortikultura kishte prezantuar edhe planifikimin e buxhetit për vitin 2017. Të hyrat e realizuara janë 59% më pak se shuma e planifikuar. Kjo për shkak të kërkesës së ulët për shërbime nga Komuna e Prishtinës. Megjithatë, ndërmarrja një gjë të tillë nuk e kishte mbështetur me një rishikimin të buxhetit ku do të refleктоhej në planin e të hyrave si dhe të shpenzimeve për të siguruar menaxhimin e duhur të ndërmarrjes.
- Rreziku** Proceset e dobëta të planifikimit duke mos i marrë në konsiderate edhe shkaqet të cilat mund të ndodhin gjatë vitit rrezikon që ndërmarrja të mos arrij objektivat dhe të mos arrij t'i mbulojë shpenzimet duke rritur obligimet ndaj furnitorëve.
- Rekomandimi 2** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që plani i biznesit bazohet në mundësitë reale të ndërmarrjes dhe realizimi i të hyrave monitorohet në mënyrë sistematike dhe ndryshimet apo devijimet e mëdha nga plani fillestar të refleктоhen në një plan të rishikuar.

3.2 Pasqyra e pozitës financiare (Bilanci i gjendjes)

Ne kemi bërë auditimin e pasqyrës së pozitës financiare, duke i testuar gjendjet e llogarive, por edhe transaksionet e ndodhura gjatë vitit në kuadër të këtyre llogarive. Përveç ekzaminimeve të gjendjes kontabël të llogarive, ne kemi trajtuar edhe aspektet e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret dhe kemi dhënë rekomandimet si më poshtë.

Tabela 2: Pasqyra e pozitës financiare të Hortikulturës më 31 dhjetor 2017

Pasuritë	Viti 2017	Viti 2016	Detyrimet dhe Ekuiteti	Viti 2017	Viti 2016
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	175,294	103,470	Llogaritë e pagueshme	2,109	27,225
Llogaritë e arkëtueshme	186,056	231,223	Obligimet për tatime dhe kontribute	18,143	45,432
Toka, ndërtesat dhe pajimet	47,548	60,526	Kapitali i pronarëve	10,000	127,253 ³
			Kapitali dhe rezervat	117,253	
			Fitimet e mbajtura	200,717	190,752
			Fitimi i vitit	60,675	4,557
Gjithsej Pasuritë	408,898	395,219	Gjithsej Detyrimet dhe Ekuiteti	408,897	395,219

³ Në PFV të vitit 2016, kapitali i pronarit dhe kapitali rezervë ishin prezantuar në një zë të vetëm, ndërsa në PFV të vitit 2017 ishin ndarë veç e veç.

Çështja 3 – Dobësi evidente në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

E gjetura

Gjatë testimit të kësaj kategorie kemi vërejtur mangësitë në vijim:

- Ndërmarrja nuk ka politika të brendshme për menaxhimin e llogarive të arkëtueshme ashtu siç kërkohet sipas nenit 9 të statutit të Ndërmarrjes. Në bazë të kontratës për mirëmbajtje të sipërfaqeve gjelbëruese mes Hortikulturës dhe Komunës së Prishtinës, (neni 24.1) Autoriteti kontraktues duhet t'i paguaj kontraktuesit shumën e certifikuar nga menaxheri i projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse autoriteti kontraktues bënë një pagesë me vonesë, kontraktuesit do t'i paguhet interesi për vonesën në pagesë. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë, e rregulluar sipas bankave vendore për kredi në sektorin e ndërtimit. Hortikultura nuk ka arritur të inkasoj shumën e mjeteve në vlerë prej 186,057€, prej të cilave 135,244€ janë obligim i qershorit 2016 dhe 50,813€ obligim i muajit dhjetor 2017, për të cilat Komuna e Prishtinës i detyrohet ndërmarrjes për shërbimet e ofruara. Po ashtu, ndërmarrja nuk kishte aplikuar masat ndëshkuese dhe nuk kishte njohur shumën nga interesi me rastin e vonesës së pagesave.
- Gjithashtu, gjatë vitit 2017 ndërmarrja u kishte dhënë paradhënie punëtorëve në vlerë prej 1,440€, të cilat pritet t'i arkëtoj prej tyre, mirëpo kjo shumë nuk ishte prezantuar e as shpalosur në PFV.

Rreziku

Mungesa e rregullores së brendshme si dhe proceset e dobëta të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, si mos inkasimi i mjeteve dhe mos aplikimi i ndëshkimeve me rastin e mos arkëtimit të mjeteve për periudha të gjata kohore ndikon në uljen e likuiditetit të ndërmarrjes dhe rrit rrezikun e mos prezantimit të saktë të llogarive të arkëtueshme në pasqyrën e pozitës financiare.

Rekomandimi 3

Kryesuesi i Bordit duhet të nxjerrë një rregullore për menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, duke përcaktuar procedura dhe kontrolle të qarta dhe kjo të jetë në harmoni me standardet dhe rregullat në fuqi. Gjithashtu, Bordi duhet të bëjë një analizë gjithëpërfshirëse të këtyre llogarive dhe në rastet kur janë plotësuar kushtet ligjore të aplikoj ndëshkimet ndaj klientëve dhe ato të evidentohen si llogari e arkëtueshme. Po ashtu, duhet të sigurojë që të gjitha llogaritë e arkëtueshme prezantohen në PFV.

Çështja 4 - Menaxhim i dobët i pasurive jo qarkulluese

- E gjetura** Pasuritë në vlerë prej 512,772€ të cilat ndërmarrja i ka pranuar si donacion nga Komuna e Prishtinës nuk janë të regjistruara fare në regjistrat e kontabilitetit të ndërmarrjes dhe për më tepër nuk posedojnë një marrëveshje ku do të specifikohen të drejtat dhe obligimet e dyja palëve. Më tej, nuk ka rregullore të brendshme për menaxhimin e pasurive jo qarkulluese dhe nuk kishte caktuar një zyrtar për menaxhimin e pasurive.
- Rreziku** Në mungesë të një marrëveshje për pasuritë e marra donacion, të një rregulloreje të brendshme dhe të një zyrtari për menaxhimin e pasurive rritet rreziku për një menaxhim jo të mirë të pasurive dhe keqpërdorimit të mundshëm të tyre.
- Rekomandimi 4** Kryesuesi i Bordit duhet që të siguroj që brenda një afati sa më të shkurtër të hartoj një rregullore të brendshme mbi menaxhimin e pasurive, ku do të përshkruheshin të gjitha procedurat për përdorimin e pasurive (të drejtat dhe detyrimet e stafit). Po ashtu, të sigurojë një marrëveshje të qartë me Komunën e Prishtinës në të cilën do të definohen të drejtat dhe obligimet e palëve dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme lidhur me trajtimin e këtyre pasurive sipas SNK-ve.

Çështja 5 - Mungesa e rregullores për përdorimin dhe menaxhimin e arkës

- E gjetura** Sipas nenit 9 të statutit të Ndërmarrjes, çështjet e caktuara të cilat nuk janë të përfshira në statut mund të rregullohen me rregullore të brendshme. Aktet e përgjithshme me propozim të Kryeshefit Ekzekutiv miratohen nga ana e BD.
- Ndërmarrja nuk kishte hartuar rregullore për menaxhimin dhe përdorim të arkës, cila duhet të përshtatet me nevojat dhe kërkesat e ndërmarrjes duke u mbështet në rregullat në fuqi. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit të rëndësisë së rregullores për menaxhimin dhe përdorimin e arkës në kohën kur Ndërmarrja kishte BD, ndërsa aktualisht kjo mungon për shkak të mungesës së BD.
- Rreziku** Mungesa e një rregulloreje që përcakton procedurat dhe mënyrën e përdorimit të arkës, rrezikon mos menaxhimin e duhur të arkës.
- Rekomandimi 5** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që është hartuar një rregullore që përcakton procedurat dhe mënyrën e përdorimit të arkës duke përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve përkatës.

Çështja 6 – Mos prezantim i saktë i detyrimeve

- E gjetura** Shënimet e kontabilitetit duhet të jenë burim i besueshëm në hartimin e pasqyrave financiare. Megjithatë, ne kemi vërejtur mospërputhje si në vijim: llogaritë e pagueshme të prezantuara në PFV ishin nënvlerësuar për 1,322€, ndërsa obligimet rrjedhëse në vlerë 766€ nuk ishin prezantuar fare në PFV. Me tej edhe pse në PFV obligimet për tatime dhe kontribute ishin prezantuar saktë (sikur në dokumentin e ATK-së, “Gjendja e përgjithshme e tatimpaguesit”), në shënimet kontabël këto obligime ekzistojnë në vlerë prej 30,253€. Po ashtu, në shënimet kontabël figurojnë obligime ndaj punëtorëve në vlerë prej 8,081€, mirëpo realisht ndërmarrja gjatë vitit kishte paguar të gjitha obligimet ndaj punëtorëve. Gjithashtu, ekziston një saldo me përshkrimin obligim ndaj sindikatës, mirëpo për shkak të mos regjistrimeve të sakta kjo shumë ishte në anën debitorë në vlerë prej 12,830€.
- Rreziku** Prezenca e obligimeve në shënimet e kontabilitetit për të cilat ndërmarrja nuk ka detyrim ndaj palëve prezanton shënime jo të sakta kontabël, ndërsa nënvlerësimi i detyrimeve krijon pa saktësi në PFV.
- Rekomandimi 6** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që janë marrë veprimet e nevojshme për t’i korrigjuar shënimet kontabël dhe të siguroj prezantim të saktë në PFV.

Çështja 7 – Mos pagesa me kohë e detyrimeve ndaj furnitorëve

- E gjetura** Hortikultura nuk kishte arritur të përmbush me kohë obligimet ndaj furnitorit në vlerë prej 2,590€. Për shkak të vonesës në pagesë (tre muaj), furnitori kishte aplikuar procedurën përmbartimore me qëllim të inkasimit të mjeteve. Kjo i ka shkaktuar ndërmarrjes shpenzime shtesë të përmbartimit në vlerë prej 500€. Shpjegimet e menaxhmentit janë se kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së mjeteve financiare.
- Rreziku** Mos pagesa me kohë e obligimeve ndaj furnitorëve mund të sjell ndërmarrjen në pozita të vështira financiare, madje rrit rrezikun që të paguaj ndëshkime dhe interesa për vonesë.
- Rekomandimi 7** Kryesuesi i Bordit duhet të merr masa të menjëhershme për pagesën e faturave duke i bërë pagesat e faturave brenda afateve ligjore, me qëllim që tu shmangët shpenzimeve shtesë.

3.3 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Ndërmarrja publike Hortikultura në pasqyrën vijuese ka prezantuar të gjitha llojet e të hyrave që ka krijuar gjatë vitit, shpenzimet, si dhe rezultatin financiar.

Tabela 3: Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve më 31 dhjetor 2017

Të hyrat	Viti 2017	Viti 2016
Të hyrat nga shitjet/shërbimet	1,025,693	955,165
Të hyrat nga donacionet	-	3,150
Gjithsej të hyrat	1,025,693	958,315
Shpenzimet e të ardhurave personale	814,609	845,155 ⁴
Shpenzimet e kontributeve të punëtorëve	40,730	
Shpenzimet e automjeteve	5,667	
Shpenzimet e mirëmbajtjes së parqeve	37,994	
Shpenzimet për mirëmbajtjes-Auto tregu	7,845	
Shpenzime tjera operative	24,852	92,965 ⁵
Shpenzimet administrative	6,492	15,131
Shpenzimet e zhvlerësimit	11,979	
Shpenzimet nga kamatat	8,108	
Gjithsej shpenzimet	958,276	953,251
Fitimi/Humbja para tatimit	67,417	5,064
Tatimi në fitim	6,742	506
Fitimi	60,675	4,557

⁴ Në këtë shumë janë të përfshira edhe shpenzimet e kontributeve punëtorëve.

⁵ Vitin 2016 shpenzimet ishin të grumbulluara në këtë zë, për dallim që këtë vit janë shpalosur për zëra të veçantë.

Çështja 8 - Dobësi evidente në menaxhimin e të hyrave

- E gjetura** Gjatë testimit të të hyrave që realizon ndërmarrja kemi vërejtur mangësitë në vijim:
- Sipas nenit 9 të statutit të Ndërmarrjes, çështjet e caktuara të cilat nuk janë të përfshira në statut mund të rregullohen me rregullore të brendshme. Aktet e përgjithshme me propozim të KE-së miratohen nga ana e BD. Ndërmarrja nuk kishte nxjerrë ndonjë rregullore, ku do të përcaktoheshin rregullat dhe kushtet për menaxhimin e të hyrave.
 - Në kontratën Kornizë në mes të Komunës së Prishtinës dhe Hortikulturës, për shërbime për mirëmbajtjen e sipërfaqeve gjelbëruese, vlera totale indikative e kontratës ishte 799,999€ devijimi i lejuar plus/minus 30%. Ndërmarrja në muajin korrik, nuk kishte arritur të faturonte për shërbimet e ofruar në vlerë prej 14,531€ për shkak se vlera e kontratës dhe devijimi i lejuar 30% ishin përmbushur. Kjo ka ndodhur si pasojë e një mos vlerësimi real të vlerës së ofertës për këto shërbime.
- Rreziku** Mungesa e një rregulloreje që përcakton procedurat, mënyrën e menaxhimit dhe kontroleve përfshirë edhe përgjegjësitë e zyrtareve, rrit rrezikun që të hyrat të jenë subjekt i gabimit apo manipulimit. Ndërsa, ofrimi i shërbimeve pa kompensim, ndikon në rezultatin financiar të ndërmarrjes.
- Rekomandimi 8** Kryesuesi i Bordit të nxjerrë një rregullore për menaxhimin e të hyrave, duke përcaktuar procedura dhe kontrole të qarta, në harmoni me standardet dhe rregullat në fuqi. Ndërsa, me rastin e përgatitjes së ofertës për shërbime për mirëmbajtjen e sipërfaqeve gjelbëruese, vlera e ofertës të jetë në harmoni me kërkesën për punë.

Çështja 9 – Vazhdimi i punës pas skadimit të kontratës

- E gjetura** Sipas Ligjit të Punës, kontratat me afate të caktuara, kanë të përcaktuara afatin kohor të marrëdhënies së punës. Gjatë testimeve tona kemi vërejtur se kontratat e katër zyrtarëve të lartë të Ndërmarrjes: Kryeshefit Ekzekutive, Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit, Sekretarit Korporativ dhe Auditorit të Brendshëm nga viti 2015 u kishte skaduar kontrata dhe ata vazhdojnë të ushtrojnë punën e tyre. Mos ripërtërija e kontratave të këtyre zyrtarëve ka ndodhur për shkak të mungesës së Bordit të Drejtorëve.
- Rreziku** Mungesa e kontratave për zyrtarët e lartë të Ndërmarrjes rrezikon funksionimin dhe arritjen e synimeve të Ndërmarrjes.
- Rekomandimi 9** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që zyrtarët e lartë të Ndërmarrjes kanë kontrata të marrëdhënies së punës për të siguruar funksionimin e mirëfilltë të Ndërmarrjes.

Çështja 10 – Zyrtari i prokurimit pa kontratë të marrëdhënies së punës

- E gjetura** Korniza ligjore përcakton se kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuar. Ne kemi vërejtur se Zyrtari i Prokurimit nuk ka kontratë që nga viti 2010, por vetëm një vendim i cili nuk ka afate kohore. Po ashtu në vendim thuhet, se ky vendim është bazë për lidhjen e kontratës, mirëpo akti i themelimit të marrëveshjes kontraktuale nuk ka ndodhur. Kjo për shkak se menaxhmenti i Ndërmarrjes e ka konsideruar të mjaftueshëm vetëm vendimin.
- Rreziku** Mungesa e kontratës së zyrtarit rrezikon që të mos respektohet korniza ligjore në fuqi, madje juridikisht mund të kontestohen edhe kontratat të cilat i nënshkruan ky zyrtar në emër të Ndërmarrjes.
- Rekomandimi 10** Kryesuesi i Bordit të siguroj që secili i punësuar në ndërmarrje të ketë kontratë të punës në pajtim me kërkesat ligjore dhe procedurale në fuqi.

Çështja 11 - Mungesa e aktivitetit të prokurimit për material higjienik

- E gjetura** Ndërmarrjet Publike me rastin e blerjeve të mallrave dhe shërbimeve kanë për obligim që të respektojnë të gjitha procedurat e Ligjit të Prokurimit Publik (LPP). Për furnizime me material higjienik, ndërmarrja nuk kishte zhvilluar procedura të prokurimit mirëpo furnizimet ishin realizuar pa kontratë. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së planifikimit të duhur. Më tej, blerjet e bëra duke mos u mbështetur në kontratë dhe pa proces formal të pranimit nuk japin siguri për ndodhjen dhe saktësinë e shpenzimeve.
- Rreziku** Mosrespektimi i LPP, rrezikon që fondet publike për blerje të mos përdoren në mënyrë transparente dhe të mos respektohet konkurrenca e tregut.
- Rekomandimi 11** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që blerjet e mallrave dhe shërbimeve bëhen në harmoni të plotë me Ligjin e Prokurimit Publik në mënyrë që të shmanget diskriminimi apo favorizimi i operatorëve ekonomik dhe të sigurohet shfrytëzimi efikas i fondeve publike.

Çështja 12 - Parregullsi gjatë hapjes së tenderit

- E gjetura** Me vendimin e datës 11.08.2017 për Komisionin e hapjes së ofertave për Furnizim me Fara të Luleve, Troset dhe Substrat, ishin caktuar 3 anëtarë të komisionit për hapjen e ofertave për tenderin përkatës. Gjatë ekzaminimit kemi vërejtur se në procesverbalin e hapjes së ofertave ishte nënshkruar vetëm njëri nga anëtarët e komisionit si dhe nga vet zyrtari i prokurimit, i cili nuk ishte i caktuar në komisionin për hapjen e ofertave.
- Rreziku** Mosrespektimi i vendimit të hapjes së ofertave, respektivisht mungesa e zyrtarëve përgjegjës në komisionin e hapjes dhe pjesëmarrja e zyrtarit të prokurimit në komision pa qenë i paracaktuar shkakton mos pajtueshmëri me Ligjin e Prokurim Publik.
- Rekomandimi 12** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që në procesin e hapjes së tenderëve të jenë të përfshirë personat përgjegjës dhe të caktuar me anë të vendimit. Në rast të pamundësisë së zbatimit të vendimit, duhet t'i reflektoj ndryshimet përmes shfuqizimit dhe aprovimit të vendimit tjetër..

Çështja 13 - Mungesa e zyrtarit certifikues

E gjetura Sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (neni 14) thekson: Çdo organizatë buxhetore, agjenci autonome ekzekutive dhe ndërmarrje publike duhet të ketë zyrtarin certifikues. Zyrtari certifikues është përgjegjës që të sigurojë që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur para bërjes ose autorizimit të pagesave sipas kontratës. Ndërmarrja në strukturën e saj organizative nuk kishte të vendosur zyrtarin certifikues. Mungesa e zyrtarit certifikues ka rezultuar me dobësi në menaxhimin financiar dhe në ndarjen e duhur të detyrave.

Këshilla Mungesa e zyrtarit certifikues redukton kontrollin efektiv dhe aftësinë e menaxhmentit për të monitoruar në mënyrë aktive zbatimin e autorizimit të aktiviteteve për të hyrat dhe shpenzimet.

Rekomandimi 13 Kryesuesi i Bordit duhet të bëjë një ri strukturim të stafit duke vendosur zyrtarin certifikues dhe të sigurojë ndarje të duhur të detyrave për të siguruar kontrolle efektive në procedimin e pagesave.

3.4 Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Në pasqyrën e ndryshimit në ekuitet për vitin 2017 janë prezantuar zëra të veçantë në përputhje me shumat e prezantuara në Pasqyrën e Pozitës Financiare dhe PA :

Tabela 4: Kapitali i Ndërmarrjes publike më 31.12.2017

Përshkrimi	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
KAPITALI		
Kapitali themeltar	10,000	127,253
Kapitali rezervë	117,253	
Fitimet/Humbjet e bartura	200,717	190,752
Fitimet/Humbja e vitit aktual	60,675	4,557

Mangësitë lidhur me prezantimin e kapitalit janë prezantuar tek baza për opinion.

3.5 Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme

Pasqyra e rrjedhës së parasë jep të dhëna për ndryshimet në para të gatshme gjatë periudhave raportuese të paraqitura dhe klasifikon rrjedhën e parave që arrihet nëpërmjet aktiviteteve afariste, financiare dhe investimit. Informatat rreth rrjedhës së parave të ndërmarrjes janë të dobishme për t'i dhënë shfrytëzuesit të pasqyrave financiare një vlerësim të rrjedhës së parave.

Tabela 5: Pranimet dhe shpenzimet e parasë së gatshme

Përshkrimi	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Paratë neto nga aktivitetet operative	71,825	44,207
Të ardhurat operative	1,288,800	902,756
Pagat e punëtorëve	(844,975)	(845,155)
Pagesa e parasë për tatime	(172,367)	0
Pagesa e parasë për furnitorët	(117,695)	(3,478)
Pagesat tjera	(81,938)	(9,916)
Paratë neto nga aktivitetet investive	0	(10,720)
Blerja e pajimeve/makinerive/impianeteve	0	(10,720)
Paratë neto nga aktivitetet financuese	0	0
Ndryshimi neto në para dhe ekuivalentet e parasë	71,825	33,487
Paraja dhe ekuivalentet e parasë në fillim	103,470	69,983
Rritja e parasë në fund të periudhës 31.12.2017	175,295	103,470

Mangësitë lidhur me prezantimin e Pasqyrës së Rrjedhës së Parasë janë prezantuar tek baza për opinion.

3.6 Trajtimi i shënimeve shpjeguese

Shënimet shpjeguese, paraqesin informacion lidhur me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave kontabël, të kërkuar nga SNRF-të dhe japin informacione shtesë të cilat nuk janë paraqitur në Pasqyrën e gjendjes financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, por janë të rëndësishme për t'i kuptuar cilëndo prej tyre.

Çështja 14 - Prezantim jo i plotë i shënimeve shpjeguese

E gjetura Sipas SNK 1, shënimet shpjeguese duhet të paraqiten në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Çdo zë i pasqyrave financiare duhet të referohet me informacionin përkatës në shënimet shpjeguese.

Gjatë analizës së shënimeve shpjeguese janë identifikuar dobësitë si në vijim:

- Zërat financiar në pasqyrën e pozitës financiare dhe pasqyrës së të ardhurave nuk ishin të referencuara me informacionet shpjeguese;
- Fitimet e mbajtura ishin shpalosur me diferenca në mes të shënimeve kontabël dhe pasqyrës financiare;
- Nuk ishin prezantuar informacione të detajuara lidhur në llogarinë e kapitalit rezerve;
- Detyrimet ishin shpalosur po me diferenca ashtu siç ishin prezantuar tek pasqyra e pozitës financiare; dhe
- Nuk ishin prezantuar informacione lidhur me detyrimet/pasuritë kontigjente edhe pse ekzistojnë 12 raste gjyqësore në vlerë gjithsejtë 5,174.

Rreziku Prezantimi jo i plotë dhe mangësitë e informacioneve në shënimet shpjeguese, ndikojnë në cilësinë e pasqyrave financiare, paqartësitë e shifrave të prezantuara si dhe kufizojnë përdoruesit e pasqyrave për ta kuptuar gjendjen e drejtë dhe të vërtetë të rezultateve financiare dhe afariste të ndërmarrjes.

Rekomandimi 14 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se gjatë hartimit të PFV-ve shënimet shpjeguese do të prezantojnë të gjitha informacionet e detajuara, të plota dhe të sakta sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Auditimi i PFV-ve për vitin 2016 të Hortikultura sh.a. është kryer nga një kompani private e auditimit, e cila kishte përgatitur raportin e auditorit të pavarur dhe kishte dhënë opinion të kualifikuar, për dy çështje të cilat i kemi cekur tek baza për opinion (çështje të tjera). Në fund të vitit 2016 këto çështje ishin korrigjuar dhe reflektuar edhe në PFV-të e vitit 2016, rrjedhimisht të dy rekomandimet janë zbatuar. Auditori i pavarur që ka bërë auditimin e viteve paraprake të Hortikultura sh.a nuk ka përgatitur letër për Menaxhmentin (sipas tij, se nuk ka pasur çështje për të ngritur dhe për të rekomanduar ndonjë përmirësim).

Ndërsa, auditimi për PFV-të e vitit 2015, kishte rezultuar me opinion të pa modifikuar me theksim të çështjes, për shkak të mungesës së BD. Kjo mungese e BD ekziston nga viti 2015 dhe deri tani kur po raportojmë (mars 2018). Zgjedhja e BD është në kompetencë të Komisionit Komunal të Aksionarit dhe ky i fundit nga Kuvendi dhe Kryetari i Komunës së Prishtinës.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5 Qeverisja

Hyrje

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë auditimi i brendshëm, procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Pas rekomandimeve tona në Memorandumin e auditimit të fazës së ndërmjetme, ekziston një progres në kuptimin e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies. Megjithatë, ende ekzistojnë një numër i dobësive të qeverisjes brenda Hortikulturës, veçanërisht në lidhje me, mungesën e një plani për menaxhimin e rrezikut, ndikimin e ulët të auditimit të brendshëm në rritjen e efikasitetit të kontrolleve të brendshme, mungesa e komisionit të auditimit, mungesa e kodit të etikës dhe mungesa e një ueb faqeje të internetit për publikimin e rregulloreve dhe raporteve për qëllime të transparencës.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një staf i cili njëherit është Drejtori i NjAB. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës të punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të Hortikulturës dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti zbatimit të rekomandimeve të auditimit.

Çështja 15 - Funkionim i NjAB-së jo në cilësinë e duhur

E gjetura NjAB në planin vjetor të auditimit për vitin 2017, kishte planifikuar 10 auditime, prej të cilave janë realizuar shtatë (7) auditime dhe një auditim jashtë planit me kërkesë të menaxhmentit (shërbime këshillëdhënëse). Plani vjetor i auditimit nuk ishte i bazuar në rreziqe për të përcaktuar përparësitë e aktivitetit të auditimit të brendshëm, në linjë me synimet e organizatës. Po ashtu, plani kishte mbuluar vetëm aktivitetet e vitit 2016 dhe nuk përfshinë aktivitetet aktuale që lidhen me vitin 2017. Gjithashtu, në mungesë të Komisionit të Auditimit, ky plan ishte i pa miratuar.

Rreziku Hartimi i planit vjetor të auditimit i pa bazuar në fushat me rrezik dhe duke mos përfshirë aktivitetet e vitit aktual ndikon në mos identifikimin me kohë të dobësive të kontrolleve të brendshme dhe përmirësimet e tyre të jenë të vonuara.

Rekomandimi 15 Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm, Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve duhet të siguroj që Komisioni i Auditimit (pas përzgjedhjes) rishikon në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe që përfshijnë edhe aktivitetet e vitit aktual.

Çështja 16 - Mungesa e Komisionit të Auditimit

E gjetura Është kërkesë e Ligjit për Ndërmarrjet Publike (neni 24) që Ndërmarrja të ketë Komisionin e Auditimit i cili i ka autorizimet e veta që burojnë nga ligji, ndër të tjera ka autorizime, ta udhëzoj zyrtarin e auditimit të brendshëm që të kryej detyra dhe veprime të cilat janë në kuadër të kompetencave të AB-së. Komisioni i Auditimit (KA) nuk ishte funksional që nga nëntori i vitit 2014. Kjo për shkak të mos emërimit të BD nga Aksionari.

Rreziku Mungesa e Komisionit të Auditimit, e ekspozon ndërmarrjen para shumë rreziqeve të cilat do t'i parandalonte apo zvogëlonte në masë të konsideruar përmes aktivitetit të tij mbikëqyrës ndaj punës së AB-së. .

Rekomandimi 16 Kryesuesi i Bordit duhet që të zgjedhë sa më parë Komisionin e Auditimit, që të ushtrojë detyrat në funksion të zbatimit të ligjit dhe të forcimit të kontrolleve të brendshme në ndërmarrje.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe manaxhimi i rrezikut

Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, manaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuar janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 17 - Sistemi për menaxhimin e rrezikut

E gjetura Hortikultura nuk ka bërë hapa konkret në drejtim të vendosjes së sistemit për menaxhimin e rreziqeve, nuk kishte të hartuar regjistrin e rreziqeve me qëllim të identifikimit dhe zvogëlimit të tyre në nivel të pranueshëm.

Rreziku Mos përgatitja e regjistrit të rreziqeve ndikon që menaxhmenti të mos identifikojë dhe të menaxhojë rreziqet të cilat ndikojnë në arritjen e objektivave të organizatës.

Rekomandimi 17 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ka hartuar regjistrin e rreziqeve si operative ashtu edhe financiare si mjete të cilat testojnë efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përkrahjen e objektivave të tyre të punës.

Çështja 18 - Mungesa e kodit të etikës

E gjetura Sipas nenit 35, të Ligjit nr. 03/L-087 për NP-të, të gjitha NP duhet të përgatisin, miratojnë dhe zbatojnë një kod të detyrueshëm të etikës dhe qeverisjes korporative. Kodi i etikës dhe qeverisjes korporative e zoton NP-në për zbatimin e standardeve më të larta të mirësjelljes dhe praktikave afariste. Gjatë auditimit konstatuam se Hortikultura ende nuk kishte arritur ta përgatis dhe as të miratojë një kod të etikës. Sipas tyre, ata zbatojnë Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, mirëpo asnjë nga drejtorët dhe zyrtarët e Hortikulturës nuk kishin zbatuar nenin 1.5 të këtij kodi, ku kërkohet që nga secili drejtor ta të nënshkruaj këtë Kod.

Rreziku Mungesa e një kodi të etikës rrezikon mos zbatimin e standardeve të larta të mirësjelljes nga stafi dhe menaxhmenti i ndërmarrjes.

Rekomandimi 18 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj marrjen e masave të nevojshme për të hartuar dhe miratuar një kod të etikës sipas kërkesave të ligjit për NP-të dhe e nënshkruajnë të gjithë drejtorët e ndërmarrjes.

Çështja 19 - Mos publikimi i dokumenteve në ueb faqen e internetit

- E gjetura** Neni 34.2 i Ligjit për Ndërmarrjet Publike kërkon që një kopje e plotë dhe aktuale e të gjitha rregulloreve të NP-së do të publikohet dhe mbahet në një faqe në internet me qasje publike e cila mbahet nga NP-ja. Gjithashtu, kërkohet të publikohet: plani i biznesit, raportet tre mujore dhe raportet vjetore. Hortikultura ende nuk ka krijuar një faqe të internetit për ti publikuar rregulloret dhe raportet e saj për qëllime të transparencës.
- Rreziku** Mos publikimi i rregulloreve të Ndërmarrjen në një faqe të internetit krijon mos respektim të ligjit dhe mungese të transparencës së kërkuar.
- Rekomandimi 19** Kryesuesi i Bordit duhet të krijojë një ueb-faqe të internetit të ndërmarrjes dhe të publikojë të gjitha rregulloret, raportet dhe dokumentet që i kërkon Ligji i Ndërmarrjeve Publike, për qëllim të transparencës ndaj publikut.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
Qeverisje e mirë	Kompania Hortikultura Sh.A" që nga shtatori i vitit 2014 nuk ka bord të drejtorëve pasi që nuk janë përzgjedhur ende nga Kuvendi Komunal i Prishtinës ashtu siç kërkohet nga Ligji për Ndërmarrjet Publike në Kosovë. Rrjedhimisht disa vendime që i takojnë bordit nuk kanë mundur të merren gjate periudhës raportuese.			Jo
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Pasqyrat financiare	Vlera neto e pronës, impianteve dhe pajimeve është 60,526€. Prona impiantet dhe pajimet janë rritur me 1 janar 2016 për shumën 21,526€ për gabimet në regjistrimet dhe prezantimet në vitet e mëparshme. Si pasojë, vlera neto e pronës, impianteve dhe pajimeve me 31 dhjetor 2015 është nënvlerësuar për 21,526€, po ashtu shpenzimet e zhvlerësimit janë të mbivlerësuara dhe nuk përputhen me shpenzimin real i cili do duhet të ishte prezantuar.	Po		
Pasqyrat Financiare	Vlera e parasë dhe ekuivalentëve të parasë me 31 dhjetor 2015 është 69,983€. Ne këtë shumë nuk ka qenë e pasqyruar llogaria bankare e cila është dedikuar për donacionet nga UNDP, nga kjo ka rrjedh që paraja dhe ekuivalentet e parasë janë nënvlerësuar për 2,740 me 31 dhjetor 2015. Ndërsa në vitin 2016 të gjitha këto informata janë prezantuar në rregull (edhe si të hyra edhe si shpenzime).	Po		

Shtojca III: Letër Konfirmimi



HORTIKULTURA SH.A
PRISHTINË

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2017 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësajshkresë, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të Hortikultura Sh.A., për vitin 2017 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Isak Rakovica,

Kryshef Ekzekutiv,



Data: 03.05.2018, Prishtinë,